



Down Syndrome

2013 • **Albania** • 2023

RAPORTI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMI FINANCIAR I PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR PERIUDHËN 2021-2022

nga Elivar Golemi



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqesojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit



RAPORTI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMI FINANCIAR I PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR PERIUDHËN 2021-2022

Autore: Elivar Golemi

Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Ambasadës Amerikane në Shqipëri në kuadrin e projektit “Bordi Kombëtar dhe Advokues PRO PAK”, i cili zbatohet nga “Fondacioni Down Syndrome Albania” (DSA). Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e DSA dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Amerikane.

1



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë.



PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria shpenzon rreth 9.5 përqind të produktit të brendshëm bruto (PBB) për mbrojtjen sociale, sa gjysma e normës mesatare prej 18.6 përqind e PBB-së referuar 27 vendeve të Bashkimit Evropian¹. Për vitin 2022, totali i shpenzimeve të planifikuara për funksionin e mbrojtjes sociale është rreth 180 miliardë lekë, ku peshën kryesore e zënë pensionet dhe papunësia, ndërsa përkujdesja sociale zë 15% të fondit. Përkujdesja sociale përfshin pagesat dhe shërbimet për aftësi të kufizuara (PAK), mbështetjen e individëve dhe familjeve në nevojë (ndihma ekonomike - NE), bonusin e bebeve dhe të tjera shërbime sociale. Nga totali i shpenzimeve për përkujdesje sociale, mbi 98 përqind e buxhetit mbulon pagesat cash dhe më pak se 2 përqind shërbimet sociale. Fondi i planifikuar për aftësinë e kufizuar zë rreth **10 përqind të shpenzimeve të mbrojtjes sociale apo 4.1 përqind të totalit të shpenzimeve publike për vitin 2022.**

Numri i personave që trajtohen me pagesë mujore të aftësisë së kufizuar është mesatarisht rreth 144 mijë (5% e popullsisë), nga të cilët mbi 51% janë invalid pune dhe **49% raportohen me aftësi të kufizuara**. Për periudhën e monitorimit 2021-2022, numri më i lartë i përfituesve të pagesës së AK është raportuar në Maj-Qershor 2021 (71,852 persona me AK), ndërsa numri më i ulët në Janar-Shkurt 2022 (69,529 persona me AK). Numri i kujdestarëve është rreth 18 mijë, me një tendencë rënie për periudhën 2021-2022, pagesa e të cilëve i shtohet kategorisë së aftësisë së kufizuar.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) për periudhën 5-vjeçare 2021-2025 është dokumenti strategjik i Qeverisë Shqiptare për përfshirjen dhe integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara, i miratuar nga Këshilli i Ministrave në Maj të vitit 2021². Ky plan përmban aktivitetet për periudhën 2021-2025 dhe përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve, duke vënë theksin tek bashkëpunimi mes institucioneve në nivel qendror dhe vendor, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Qeveria Shqiptare, me miratimin e PKVPAK 2021–2025, ka ndërmarrë angazhimin për realizimin e disa masave dhe aktiviteteve të grupuara në **8 qëllime kryesore politike dhe 22 objektiva specifike** (Aneksi 1), zbatimi i të cilave do të mundësojë përmirësimin e shërbimeve, cilësisë së jetës dhe pjesëmarrjen e personave me AK. Për secilin aktivitet janë vendosur afatet e zbatimit, institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunuese, si dhe buxhetet financiare respektive. Në ndryshim nga plani i mëparshëm 2016-2020, **në këtë plan mungojnë treguesit e matshëm për vlerësimin e performancës së zbatimit të aktiviteteve të planifikuara**. Gjithashtu, plani i ri 2021-2025 ka patur një **reduktim të kostove, krahasuar me planin e mëparshëm**, pavarësisht se zbatimi i masave nga

¹ STRATEGJIA KOMBËTARE E MBROJTJES SOCIALE 2015-2023, RAPORT PROGRES VITI 2020
<https://shendetesia.gov.al/perkujdesi-social/>

² VKM nr. 276, datë 12.5.2021 të Keshillit të Ministrave





plani i kaluar ka qenë i ulët dhe aktivitetet janë mbartur për zbatim në planin e ri³. Rënia më e madhe e kostove është planifikuar në sektorët: **arsimi -56%, kujdesi shëndetësor -52% dhe kujdesi social -34%**.

Raporti i monitorimit të PKVPAK 2021-2025, i përgatitur nga Organizata “*Fondacioni Down Syndrome Albania*” në kuadër të projektit “*Bordi Kombëtar Advokues PROPAK*” dhe me mbështetjen e **Ambasadës Amerikane në Shqipëri**, synon të përcjellë një vlerësim paraprak të angazhimit të institucioneve përgjegjëse në zbatimin e masave të përcaktuara në planin e veprimit, me qëllim që të krijohet një proces lobimi dhe advokimi për të nxitur zbatimin në kohë dhe me efektivitet të detyrimeve të PKVPAK 2021-2025, nga institucionet përgjegjëse. Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i pjesshëm i objektivave dhe aktiviteteve të realizuara gjatë **periudhës 2021-2022**, kryesisht në **fushat e arsimit dhe të shërbimeve sociale**, pjesë e PKVPAK 2021-2025

³ RAPORT I DYTË I MONITORIMIT TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (2016-2020) “Të dhënat e këtij raporti të dytë monitorimi tregojnë se në perceptimin e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë, të gjithë qëllimet specifike ende vlerësohen në nivel aspak ose pak të kënaqshëm”.

https://adrf.al/images/publications/raporti_i_monitorimit_permbledhje.pdf





SHKURTIMET

AKPA	Agjensia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
DPPS	Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale
ISHPSHSH	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbime
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KKAK	Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KVAK	Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MK	Ministria e Kulturës
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJF	Ndihma Juridike Falas
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OPAK	Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar
QFP	Qendra e Formimit Profesional
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



Gjetjet kryesore të monitorimit:

1. Mangësi në transparencën financiare për çështjet e integritetit dhe mbështetjes sociale të PAK. Raport progresi vjetor i monitorimit të planit të veprimit nga ana e institucioneve duhet të përfshijë edhe pjesën financiare të zbatimit të planit kombëtar të veprimit, bashkë me përpjekjet e bëra për rishikimin e buxhetit apo identifikimin e donatorëve për të mundësuar zbatimin në kohë të aktiviteteve dhe përdorimin në mënyrë efektive të fondeve publike dhe ato të donatorëve apo shoqërisë civile. MSHMS dhe MAS në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, gjatë hartimit të projekt buxheteve vjetore duhet të parashikojnë në programe të veçanta, sipas zërave të shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore veprimtaritë e përcaktuara në PKVPAK, duke bërë transparente buxhetin faktik të shpenzimeve operacionale për PAK dhe koston e zbatimit të planit 5-vjeçar. Ky raportim mungon, qoftë në shqyrtimin e programeve buxhetore afatmesme të detajuara sipas institucioneve dhe objektivave, ashtu edhe në raportimet e monitorimit të buxhetit nga vetë institucionet përgjegjëse.
2. Mungesë konsistence në statistikat për personat me AK. Statistika të ndryshme të raportuara në dokumente të ndryshme vënë në diskutim saktësinë e të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse. Pavarësisht nismave të ndërmara nga qeveria në vitin 2017 për të krijuar regjistrin e integruar elektronik kombëtar për PAK, aksesin në informacion mbetet një nga problematikat e adresuara më së shumti ndër vite, ende e pazgjidhur për çështjet e arsimit dhe mbrojtjes sociale.
3. Njësitë vendore ende nuk kanë bërë planifikime në buxhet për aksesueshmërinë në planet e zhvillimit social-ekonomik. Nevojitet të alokohen fonde në mënyrë specifike për masat mbi aksesueshmërinë.
4. MAS nuk ka një metodologji për funksionimin e shkollave speciale si qendra burimore për fëmijët me AK, nuk ka një metodologji apo standarde të unifikuara për ngritjen e klasave zhvillimore nëpër institucionet arsimore. MAS ka miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026, shoqëruar me planin e veprimit për zbatimin e saj, por ky plan nuk është shoqëruar me masa konkrete për fëmijët me AK, për të mundësuar arritjen e objektivave dhe koordinimin me PVKPAK 21-25.
5. KLSH⁴ ka adresuar faktin se MSHMS dhe institucionet e varësisë nuk kanë informacion sa mjek janë të angazhuar në procesin e vlerësimit të Komisioneve Multidisiplinare të ngritura nga institucionet arsimore, si mungese serioziteti dhe neglizhencë në kryerjen e një procesi shumë të rëndësishëm siç është vlerësimi i nevojave arsimore të fëmijëve me AK.
6. KLSH ka evidentuar mungesë të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve mbështetëse jashtë shkollës për fëmijët me AK (terapi zhvillimi, terapi sjellje, logopedi), pasi numri dhe kapacitetit i institucioneve ku fëmijët mund të marrin këto shërbime janë shumë të pakta.


⁴ KLSH _ Raport Auditimi Performance “Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara”, Dhjetor 22



1. Hyrje

Sipas raportimeve të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), për vitin 2022⁵ statistika më e fundit e numrit të personave që trajtohen me pagesë të aftësisë së kufizuar është rreth 143,247, nga të cilët 72,757 persona janë invalid pune (51%) dhe **70,490 persona raportohen me aftësi të kufizuara (PAK - 49%)**. Nga këta të fundit, 74% janë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike (52,009 persona), 18% janë të verbër (12,547 persona), dhe 8% janë para-tetraplegjik (5,934 persona), siç paraqitet në Figurën 1. Sipas studimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 15% e popullsisë botërore dhe një në dhjetë fëmijë në mbarë botën ka aftësi të kufizuara, që nënkupton se numri real i personave me AK mund të jetë akoma më i lartë në Shqipëri, por të trajtuar zyrtarisht si persona me AK rezultojnë rreth 5 përqind e popullsisë në Shqipëri (PAK dhe Invalid Pune).

Figura 1. Numri i përfituesve sipas kategorive



Burimi: Shërbimi Social Shtetëror


Nga totali i PAK, rreth **15 mijë është numri i fëmijëve të raportuar me aftësi të kufizuara**, ndërsa 18 mijë persona marrin pagesë për të mbuluar shërbimin e ndihmësit personal (mesatarisht një në katër persona me AK përfiton pagesë kujdestarie përveç pagesës së AK), ku peshën më të lartë e ka kategoria e para-tetraplegjikeve - 99% përfitojnë kujdestari, kategoria e të verbërve - 26% përfitojnë kujdestari dhe personat me aftësi të kufizuar mendore e fizike - 17% përfitojnë kujdestari. Statistikat e detajuara sipas kategorive dhe prefekturave paraqiten në Aneksin 2.

Numri total i përfituesve PAK është i ndryshueshëm në kohë, siç paraqitet në Figurën 2. Për periudhën në monitorim 2021-2022, numri më i lartë i përfituesve PAK është raportuar në Maj-Qershor 2021 (71,852 PAK), ndërsa numri më i ulët në Janar-Shkurt 2022 (69,529 PAK). Numri i kujdestarëve ka

⁵ Raportimi me i fundit është i periudhës Shtator – Tetor 2022, <https://www.sherbimisocial.gov.al/perfituesit-e-pak-2022/>


qenë në rënie. Në Shtator-Tetor 2022 raportohet se rreth 25.6% e PAK përfitojnë pagesë për kujdestari, nga 26.8% që e përfitonin këtë pagesë në Janar-Shkurt 2021. Siç vërehet në Figurën 3, rreth 35% e PAK janë të regjistruar në zonën Tiranë-Elbasan. Për prefekturën e Tiranës raportohet se 33% e PAK përfitojnë kujdestari, ndërsa në Prefekturën Elbasan ky tregues është shumë më i ulët, ku vetëm 17% e PAK përfitojnë kujdestari. Pjesa tjetër, rreth 75% e PAK janë të regjistruar në 10 prefekturat e tjera, ku mesatarisht 27% e PAK përfitojnë kujdestari, përveç Korçes dhe Fierit ku rreth 23-24% e PAK përfitojnë kujdestari.

Figura 2. Numri total i përfituesve PAK dhe Kujdestarë gjatë periudhës 2021-2022



Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

Figura 3. Numri total i përfituesve PAK dhe Kujdestarë sipas Prefekturave, Tetor 2022



Burimi: Shërbimi Social Shtetëror

2. Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025

PKVPAK për periudhën 2021-2025, miratuar me VKM nr. 276, datë 12.5.2021, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara,



për zbatim brenda periudhës 5-vjeçare. Ky plan vjen si një dokument i përditësuar i planit kombëtar të veprimit për periudhën 2016-2020. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK).

MSHMS mban peshën kryesore të zbatimit të planit, duke qenë institucioni direkt përgjegjës për numrin më të lartë të masave të planifikuara për 5-vjeçarin, ndjekur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS). Një nga qëllimet kryesore të PKVPAK lidhet me nevojën e monitorimit të vazhdueshëm të aktiviteteve të realizuara dhe të rezultateve të pritshme për periudhën 2021-2025.

Në vijueshmërinë e përditshme, përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit qëndron tek nëpunësit përgjegjës të ministrive të linjës, të cilët vënë në jetë aktivitetet, mbledhin të dhëna dhe dorëzojnë raportet e progresit për çdo sektor. Në planin e veprimit konfirmohet se të gjitha ministrinë kanë identifikuar një nëpunës përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar bazuar edhe në Ligjin 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e PAK”, por përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre për këtë fushë nuk janë përfshirë në përshkrimin detyrave të tyre të punës.

Zbatimi i PKVPAK 2021-2025 në nivel qeverisje monitorohet nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK), nëpërmjet Sekretariatit Teknik dhe me përfshirjen direkte të personave përgjegjës në ministrinë e linjës. Plani përcakton Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) si institucionin përgjegjës kryesor për progresin e tij, pavarësisht se pjesa më e madhe e aktiviteteve kërkon bashkëpunim ndërmjet aktorëve të ndryshëm, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e shoqërisë civile.

Plani i veprimit parashikon detyrimin e publikimit të **raport progresit vjetor** gjatë 5 viteve të ardhshme dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile, por deri në fund të vitit 2022 nuk ka patur një publikim të raportit progresit vjetor. Sipas korrespondencës me MSHMS, procesi i monitorimit të planit kombëtar të veprimit ka qenë i vazhdueshëm dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera. MSHMS nuk ka komentuar mbi përgatitjen e raportit progresit vjetor, por pohon se një raport afatmesëm i monitorimit të PKVPAK planifikohet të përgatitet dhe të miratohet në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar dhe Grupin e Menaxhimit të Politikave të Integruara.

Në kuadër të projektit “**Bordi Kombëtar Advokues PROPAK**”, propozuar nga “**Fondacioni Down Syndrome Albania**” dhe mbështetur nga Ambasada Amerikane në Shqipëri, u realizua ky raport i parë monitorimi i objektivave dhe aktiviteteve të realizuara gjatë **periudhës 2021-2022**, kryesisht në **fushat e arsimit dhe të shërbimeve sociale**, pjesë e PKVPAK 2021-2025.





Objektivat: Ky raport synon të përcjellë një vlerësim të pjesshëm të angazhimit të institucioneve përgjegjëse në zbatimin e masave të përcaktuara në PKVPAK, si dhe analizën financiare të planit lidhur me shërbimet e përfituara dhe lehtësitë e krijuara për gjithëpërfshirjen sociale dhe ekonomike të personave me aftësi të kufizuara, duke e vlerësuar si një paketë të plotë bashkë me buxhetin ekzistues për personat me aftësi të kufizuara.

Synimi: Ky raport synon të krijojë një procesi lobimi dhe advokimi për të nxitur zbatimin në kohë dhe me efektivitet të detyrimeve të PKVPAK 2021-2025, nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia: Për përmbushjen e synimit dhe objektivave të raportit të monitorimit është përdorur metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave nga vetë institucionet përgjegjëse, nga raportet e institucioneve monitoruese dhe audituese, si dhe analiza financiare buxhetore e dy institucioneve kryesore të përfshira në planin e veprimit (MSHMS dhe MAS). Në monitorim u përfshinë edhe disa shoqata dhe persona me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, për një vlerësim paraprak të perceptimit të shërbimeve të ofruara, por pa synuar matjen e impaktit.

3. Masat e realizuara gjatë periudhës 2021-2022 në lidhje me PKVPAK 2021-2025

Në planin e përditësuar për periudhën 2021-2025 janë identifikuar gjithsej 207 aktivitete (179 aktivitete në planin e mëparshëm të periudhës 2016-2020). MSHMS mban peshën kryesore të aktiviteteve, duke qenë institucioni direkt përgjegjës për 42 përqind të masave të planifikuara, ndjekur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS), të cilët janë direkt përgjegjës përkatësisht për 14 përqind dhe 13 përqind të masave të planifikuara për 5-vjeçarin (Aneksi 4). Institucionet e tjera kanë peshë më të vogël por nevojitet bashkëpunimi i tyre për zbatimin me sukses të PKVPAK. Referuar planit të veprimit për 5-vjeçarin, 81 përqind e aktiviteteve duhet të kenë filluar zbatimin në periudhën e monitorimi 2021-2022, nga të cilat **30 aktivitete planifikohet të jenë përfunduar brenda kësaj periudhe** (Aneksi 5).

Kosto totale për PKVPAK për periudhën 5-vjeçare është vlerësuar rreth 1.47 miliard lekë. Nga buxheti total i këtij plani, rreth 460 milion lekë janë planifikuar në programin e buxhetimit afatmesëm 2021-2023 (31% e kostos totale), mbi 100 milion lekë do të sigurohen nga donatorë të huaj (7% e kostos totale), 645 milion lekë do të përfshihen në programin e buxhetimit 2024-2025 (44% e kostos totale), dhe diferenca prej 262 milion lekë (18% e kostos totale) përbën hendek financiar dhe planifikohet të grumbullohen nga donatorë të tjerë gjatë periudhës 5vjeçare (Aneksi 3). Vlen të theksohet fakti se mungesa e fondeve të vëna në dispozicion të planit mund të jetë një faktor që e ngadalëson procesin e realizimit të objektivave të përcaktuara në këtë plan.

Tabela 1. Lista e përmbledhur e masave sipas institucioneve përgjegjëse dhe afatit të zbatimit

Masat e planit 5-vjeçar PKVPAK 21-25				
Institucioni përgjegjës	5 vjecari		Masa qe fillojne nga zbatimi ne 2021-2022	nga te cilat: Masa qe perfundojne zbatimin ne 2021-2022
	Pesha %			
MSHMS	87	42%	71	15
MFE	28	14%	24	6
MASR	26	13%	18	1
MD	14	7%	5	4
MIE	11	5%	11	1
AKSHI	10	5%	10	1
AMA	9	4%	9	0
KQZ	8	4%	5	0
MK	6	3%	6	2
AKEP	5	2%	5	0
Pa institucion	2	1%	2	0
NJVQV	1	0%	1	0
Te gjitha masat	207	100%	167	30
			81%	14%



Organizata “Down Sindrome Albania” i është drejtuar zyrtarisht dy institucioneve kryesore përgjegjëse MSHMS⁶ dhe MAS⁷, duke i dërguar disa pyetje për informacion dhe listën e plotë të aktiviteteve për periudhën respektive sipas përkatësisë, me qëllim marrjen e informacionit për zbatimin e masave konkrete (Aneks 6.1 & 6.2).

MAS⁸ ka dërguar një përgjigje formale që ngarkon MSHMS si përgjegjëse për raportimet mbi zbatimin e PKVPAK, pa dhënë përgjigje konkrete për statusin e zbatimit të masave për të cilat është direkt përgjegjës ky institucion.

MSHMS⁹ ka dërguar një përgjigje të përgjithshme përshkrimore të masave të ndërmarra në zbatim të planit kombëtar të veprimit, strategjisë së mbrojtjes sociale¹⁰ dhe reformës së vlerësimit të personave me AK¹¹, por pa iu referuar listës konkrete të masave të identifikuar në PKVPAK 2021-2025 dhe statusit të zbatimit të secilës masë, për të cilat është direkt përgjegjës ky institucion. Nga korrespondenca e MSHMS për raportin e monitorimit, si dhe nga shqyrtimi i dokumenteve dhe informacioneve të tjera të publikuara nga institucionet lidhur me çështjen e aftësisë së kufizuar, rezulton se janë zbatuar disa aktivitete por ka edhe disa mangësi të cilat përmbledhen në vijim.

➤ **Akte ligjore të miratuara gjatë periudhes së monitorimit:**

- VKM nr. 436 datë 22.06.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me AK
- VKM nr. 470 datë 06.07.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriteret e vendimarrjes së mbështetur për personat me AK”
- Ligji Nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” i cili jep një përkufizim ligjor të rolit të përkthyesit të gjuhës së shenjave për personat që nuk dëgjojnë.
- Ligji nr. 20/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” i ndryshuar.

3.1 Politikat 1 dhe 2 - Aksesueshmëria:

➤ **Masa të konfirmuara nga institucionet si të realizuara:**

- MSHMS konfirmon se është siguruar aksesueshmëria në qendrat shëndetësore, poliklinikat, spitalet, institucionet sociale ku ushtrojnë veprimtarinë komisionet shumëdisiplinore.

⁶ Korrespondenca e DSA për MSHMS “Kërkesë për informacion” nr. 3716 datë 27.09.2022

⁷ Korrespondenca e DSA për MAS “Kërkesë për informacion” nr. 6222 datë 27.09.2022

⁸ Korrespondenca e MAS “Kthim përgjigje” nr. 6222/1 datë 05.10.2022

⁹ Korrespondenca e MSHMS “Kthim përgjigje” nr. 3716/2 datë 21.11.2022

¹⁰ Strategjia e mbrojtjes sociale 2020-2023 dhe Plani i Veprimit (VKM nr.866, datë 24.12.2019)

¹¹ Dokumenti Politik i Reformës së Vlerësimit të AK në Sistemin e Mbrojtjes Sociale 2019-2024 dhe Plani i Veprimit (VKM nr.380, datë 05.06.2019)

- MAS konfirmon se është siguruar aksesueshmëria në **300 shkolla** nga 1,200 shkolla në total (25% e shkollave).
- Në nivel qeverisje vendore janë hartuar planet lokale për aksesueshmërinë vetëm në **tre bashki: Pogradec, Lezhë dhe Përmet**.
- Po punohet në drejtim të ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të pikave fokale në nivel qendror dhe lokal.
- Aksesit në ndihmën juridike falas ofrohet për kategorinë e personave me AK sipas përcaktimeve në ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike”.
- Vijon procesi për zbatueshmërinë e ligjit për përkthimin zyrtar, ku përfshihet edhe shërbimi i interpretit të gjuhës së shenjave në shërbimet e përkthimeve zyrtare.

➤ **Mangësi të evidentuara:**

- Njësitë vendore ende nuk kanë bërë planifikime në buxhet për aksesueshmërinë në planet e zhvillimit social-ekonomik. Nevojitet të alokohen fonde në mënyrë specifike për masat mbi aksesueshmërinë.¹²
- Mungon aksesueshmëria në transportin publik për personat me aftësi të kufizuara.
- Mungon informacioni mbi funksionimin e Task Force për monitorimin e masave të aksesueshmërisë.
- Ridizenjimi i faqes së internetit të DNJF, me qëllim që të jetë e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.
- Mungesa e një studimi për vlerësimin e situatës së personave me AK në lidhje me kapacitetin ligjor për të vepruar.

3.2 **Politika 3 - Punësimi:**

➤ **Masa të konfirmuara nga institucionet si të realizuara:**

- Plani i veprimit i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019 - 2022 raporton se 697 punëkërkues të papunë me aftësi të kufizuara janë regjistruar në zyrat e punës deri në prill 2021. Por punësimi mbetet i ulët dhe vetëm **18 persona me AK** raportohen të punësuar deri në korrik 2021, me ndërmjetësim ose të gjetur punë individualisht¹³.
- Sipas raportimeve të MFE-së¹⁴, nga programet e nxitjes së punësimit kanë përfituar 2,238 punëkërkues gjatë viti 2021, nga të cilët **14 persona me AK**.

¹² PKIE 2022/2024 - **Përfshirja Sociale dhe Personat me Aftësi të Kufizuara**

¹³ PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN, 2022 – 2024

¹⁴ National Employment and Skills Strategy 2019 – 2022 Annual Progress Report 2021 June 2022 Tirana, Albania

<https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/NESS-Annual-Progress-Report-06.09.2022.pdf>



- Në 2021 janë ofruar trajnime profesionale për **58 persona me AK**.

➤ **Mangësi të evidentuara:**

- Referuar objektivit të mbështetjes së personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale, sipas planit **synohet të punësohen 200 persona për vitin 2022**, tregues që është ulur në 70 të punësuar për vitin 2023. Shpenzimet për programin e punësimit të PAK janë paraqitur me mosrealizim për vitin 2021 ashtu edhe për 8-mujorin e vitit 2022.
- Mangësi në lidhje me procedurat e inspektimit për zbatimin e ligjit të lidhur me punësimin e personave me AK në të gjithë vendin.
- Mangësi në lidhje me statistikën e publikuar në lidhje me informacionin për personat me AK si punëkërkuar të papunë dhe në përputhje me të dhënat e marra nga Rregjistri elektronik i aftësisë së kufizuar.

3.3 Politika 4 - Arsimi gjithëpërfshirës:

➤ **Masa të konfirmuara nga institucionet si të realizuara:**

- Sipas MAS, në vitin akademik 2020-2021, numri i fëmijëve me AK në arsimin publik raportohet të jetë rritur me 64% krahasuar me vitin akademik 2014-2015, duke arritur në **3,575 fëmijë me AK**. Vetëm **11.5% e fëmijëve me AK të regjistruar në arsimin parauniversitar ndjekin institucionet e arsimit special**.
- Mbështeten me **pagesa të dyfishuara dhe të trefishuara nxënësit dhe studentët me AK** të cilët ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, apo gjatë përfshirjes në kurse të arsimit profesional, pjesë e programit të mbrojtjes sociale.
- Nxënësit me AK, përfshirë personat që nuk dëgjojnë, përfitojnë **transport falas në arsimin parauniversitar**, trajtim falas në institucionet e arsimit special, tekste falas dhe kompensim për cmimin e teksteve, të ndara në grupet në nevojë.
- Profili i mësuesit të arsimit special është përcaktuar si profesion i rregulluar dhe po punohet për t'u dhënë përparësi mësuesve të licencuar në këtë profil si mësues ndihmës për fëmijët me AK.
- Në sistemin e arsimit parauniversitar publik dhe privat gjatë vitit 20-21, përfshirë arsimin parashkollor, janë punësuar rreth **1,275 mësues ndihmës për fëmijët me AK**. Raporti fëmijë me AK për mësues ndihmës në 2021 është 3.7 (pra për çdo 4 fëmijë me AK kanë një mësues ndihmës në dispozicion). Numri i mësuesve ndihmës është rritur me rreth 250 mësues, duke përmirësuar raportin mësues ndihmës/ fëmijë me AK.
- Studentët me AK përfitojnë **përrjashtim nga tarifat vjetore të shkollimit** në institucionet publike të arsimit të lartë dhe bursa studimi në institucionet publike të arsimit të lartë.
- Në Institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë mbulohen **shpenzimet për akomodim dhe tekste**.

Tabela 2. Numri i fëmijëve AK në sistemin arsimor dhe numri i femijeve me AK në total

Femije me aftësi të kufizuara (FAK) sipas viteve	Gjithsej	Nga keta: FAK qe ndjekin sistemin arsimor	Pesha %	Nga keta: FAK femra	Pesha %
2020	15,685	8,442	53.8%	7,252	46.2%
2021	15,181	7,877	51.9%	7,017	46.2%
6M I 2022	14,558	7,501	51.5%	6,690	45.9%

Burimi KLSH

➤ **Mangësi të evidentuara:**

- MAS nuk ka një metodologji për funksionimin e shkollave speciale si qendra burimore për fëmijët me AK. Nuk ka një metodologji apo standarde të unifikuara për ngritjen e klasave zhvillimore nëpër institucionet arsimore.
- MAS ka miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026, shoqëruar me planin e veprimit për zbatimin e saj, por ky plan nuk është shoqëruar me masa konkrete për fëmijët me AK, për të mundur arritjen e objektivave dhe koordinimin me PVKPAK 21-25.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë auditimit të performancës së sistemit arimor parauniversitar në përfshitjen e femijeve me AK, ka adresuar disa gjetje dhe mangësi, si vijon¹⁵:
 - Mangësi në infrastrukturën e duhur në ndihmë të nxënësve me karroca dhe nxënësve me probleme në shikim. Rreth 60% e institucioneve arsimore janë të aksesueshme fizikisht për fëmijët me AK, për hyrjen në godinë por jo për të aksesuar të gjitha ambientet.
 - Mungesa të theksuara në lidhje me sigurimin e mjeteve didaktike. Në institucionet arsimore të zakonshme nuk ka mjete didaktike për fëmijët që nuk dëgjojnë si dhe mungojnë ambientet e dedikuara për fëmijët me AK intelektuale.
 - Nuk janë siguruar kushtet optimale të punës për ofrimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore. Fëmijët me AK nuk pajisen me dëftesë pas përfundimit të çdo klase, e cila të përmbajë rubrikën ku përshkruhen objektivat kryesorë të Planit Edukative Individual *PEI, nuk pajisen me dëftesën e posaçme, që nxënësi me AK ka përfunduar provimet kombëtare të arsimit bazë, nuk janë kryer provime kombëtare duke iu nënshtruar një testi të posaçëm të hartuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore për PAK.
 - Nuk ka një ndarje të numrit të mësuesve ndihmës pjesëmarrës në trajnime sipas cikleve, ekzistojnë mësues ndihmës të pakualifikuar në fushën e pedagogjisë speciale, ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës bëhet e vështirë sepse këto drejtues ndërrohen/zëvendësohen shpesh dhe investimi i nisur përmes trajnimeve të tyre bëhet i vështirë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar nuk ka raport të dhënash për numrin e mësuesve ndihmës të trajnuar nga agjencitë e akredituara,

¹⁵ KLSH _ Raport Auditimi Performance “Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara”, Dhjetor 22

gjithashtu: trajnimi nuk ka qenë i disponueshëm në nivel lokal; mësuesit nuk kanë pasur mundësi financiare për të mbuluar trajnimin; trajnimet janë zhvilluar brenda orarit mësimor dhe mësuesi ndihmës nuk mund të marrë leje për të marrë pjesë në të, etj.

- Në lidhje me funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare, KLSH ka adresuar disa mangësi, si:
 - Në Zyrat Vendore Arsimore, Checklist e përdorur nga Komisionet Multidisiplinare, me të cilën vlerësohen nevojat arsimore të nxënësve me AK nuk është sipas ICF Checklist të miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë por, është shumë e reduktuar, e hartuar nga çdo ZVA dhe e pa miratuar nga MARS.
 - Për nxënësit me AK që rivlerësohen periodikisht aplikohet një format rivlerësimi në bazë të arritjeve të pritshme dhe nevojave që nxënësi mund të shfaq vit pas viti, por kjo procedure është e pa unifikuar në nivel kombëtar dhe e pa monitoruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
 - Komisioni Multidisiplinar i vlerësimit të fëmijëve me AK përballet me kërkesat e vazhdueshme të prindërve që fëmijët të mos ndryshojnë mësuesin mbështetës vit pas viti, pasi kjo ndikon negativisht tek ecuria e fëmijëve në mësim.

3.4 Politika 5 – Shërbimet dhe Mbrojtja Sociale:

➤ **Masa të konfirmuara nga institucionet si të realizuara:**

✚ **Reforma e vlerësimit të personave me AK:**

- Sipas konfirmimeve të MSHMS, aktualisht janë **32 komisione shumëdisiplinore për AK** që funksionojnë në **9 qarqe** në nivel kombëtar (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Vlorë, Korçë, Fier) ku po zbatohet reforma e vlerësimit bio-psiko-social. Po punohet për shtrirjen e skemës në 3 qarqet e mbetura.
- Banka Botërore ka mbështetur zbatimin e reformës së re në rajonin e Tiranës. Rezultatet dhe impakti në jetesën e personave me AK do të prezantohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (Aneksi 7).
- Fushata komunikimi dhe takime të vazhdueshme janë zhvilluar me bashkitë dhe njësitë administrative të 9 qarqeve. Janë ngritur kapacitetet e stafeve referuese, mjekë familje dhe mjekë specialistë, përmes disa ciklesh trajnimi të akredituara nga Agjensia për Sigurimin e Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Social. Janë zhvilluar trajnime me stafet e komisioneve të vlerësimit bio-psiko-social, stafet sociale në nivel lokal, etj, përfshirë vlerësimin e nevojave për karrige me rrota dhe mjete ndihmëse.
- Lehtësimi i procedurave për vlerësimin bio-psiko-social, duke përfshirë trajtimin nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist, pa qenë nevoja e shtrimit në spital. Kriteret e vlerësimit janë të veçanta si për fëmijët dhe për të rriturit.
- Mbështetja financiare për personat me AK është përcaktuar në 4 nivele përfitimi dhe për shërbimin e ndihmësit personal në dy nivele përfitimi.

Mbështetja e ofruar për personat me AK gjatë pandemisë COVID:

- Sipas konfirmimeve të MSHMS, rreth **147,000 persona me AK dhe invaliditet** përfituan pagesat e aftësisë së kufizuar të cilat nuk u ndërprejnë gjatë periudhës së pandemisë, pavarësisht se komisionet u pezulluan, deri në momentin e rivlerësimit.
- Rreth **8,100 familje në nevojë, që kanë në përbërje persona me AK**, kanë përfituar masën e dyfishuar të ndihmës ekonomike.
- Ofrimi i asistencës në banesë: dërgimi i asistencës NE dhe pagesës së aftësisë së kufizuar, pensioneve të invaliditetit dhe produkte ushqimore, jo-ushqimore apo barna të rimbuesueshme.
- Ofrimi i shërbimeve sociale on-line për fëmijët me AK, përmes një rrjeti në internet të profesionistëve në **8 qendra të zhvillimit** të fëmijëve me AK (Pogradec, Lushnje, Bulqizë, Dibër, Shijak, Ura Vajgurore, Përmet, dhe Sarandë).
- Njoftimet nga NSHMS gjatë pandemisë u shoqëruan me interpretim në gjuhën e shenjave.

Funksionimi i Fondit Social:

- **60 bashki kanë hartuar Planet Vendore Sociale** bazuar në analizën e nevojave dhe janë buxhetuar projekte konkrete ndërhyrjeje, pjesë e Fondit Social nga buxheti qendror i shtetit, i cili ngarkon bashkitë me hartimin dhe miratimin e planeve në Keshill Bahskiak.
- **40 bashki janë mbështetur nga UNICEF, UNDP dhe World Vision** për të zhvilluar dhe hartuar planet sociale të kujdesit shoqëror të cilat janë bazat për ndërtimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Stafi i shërbimeve sociale në **19 bashki janë trajnuar për përdorimin e MIS** (Regjistri Elektronik) për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe trajnim, i cili vazhdon me mbështetjen e UNICEF.
- MSHMS ka filluar të bëjë funksionale Fondin Social duke i akorduar **14 bashkive** mbështetje financiare nga Fondi Social për vitin 2020, për krijimin e **14 shërbimeve të reja**, me një fond **61,412,587 ALL**. Synohet që deri në fund të vitit 2022 të financohen 35 bashki.
- Shërbimet e Kujdesit Social të ofruara për personat me AK për vitin 2021, të mbështetura nga Fondi Social u krijuan në **Tiranë, Librazhd, Lushnje, Lezhë, Kavajë**.¹⁶
- Janë ofruar shërbime të reja për personat me AK, krahas shërbimeve ekzistuese të kujdesit rezidencial, të mbështetura nëpërmjet Fondit Social. Shërbime që ofrohen nga 5 shërbime lëvizëse për rreth **560 përfitues me AK, nga të cilët rreth 230 fëmijë**.
- Shërbime të specializuara për AK ofrohen në 4 qendra përkujdesi për PAK me rreth **180 përfitues** dhe 2 qendra ditore për fëmijët me AK me rreth **80 përfitues**, të cilat ofrojnë tipologji të reja, krahas shërbimeve rezidenciale dhe ditore në nivel kombëtar.

¹⁶ PKIE 2022-2024 – Seksioni: Përfshirja Sociale dhe Personat me Aftësi të Kufizuar

- Ofrimi i shërbimeve për PAK me mjete asistive – reth **700 karrige me rrota janë ofruar çdo vit** me nje fond 6.8 milion lekë në vit.
- Sipas objektivave të MSHMS, është realizuar mbështetja e fondit social për njësitë e vetqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE me paketa sociale shëndetësore, me një **fond nga 200 milion lekë në 300 milion lekë** për vitet 2023-2025, nderkohe qe planifikohet te rritet edhe numri i shërbimeve të ofruara **nga 35 ne 45 per vitin 2023** dhe 3-vjecarin në vijim.

Strehimi social:

- Janë zbatuar programe të tilla si: skema e aplikimit të bonusit të qirasë, granti i menjëhershëm projekte për përmirësimin dhe përshtatjen e kushteve të strehimit, si dhe investime në nivele të ulëta në strehim me kosto.
- Numri i familjeve përfituese nga programet e strehimit për vitin 2019, sipas PKIE 22-24

Tabela 3. Numri i PAK që kanë përfituar nga shërbimet e strehimit social

Programi	Numri i familjeve përfituese	Numri i familjeve me përfitues PAK	Në %
Subvencionim të qirasë në treg të lirë	536	201	37.5%
Projekte për përmirësimin dhe përshtatshmërinë e kushteve të banimit	634	7	1.1%
Grant të menjëhershëm	26	25	96.2%
Banesa me kosto të ulët	84	12	14.3%
Totali	1280	245	19.1%

Mangësi të evidentuara:

- Rishikimi i bazes ligjore me qëllim shtrirjen e përfitimit nga zbatimi i programeve të strehimit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
- Rishikimi i legjislacionit lidhur me zgjerimin e përfitimit të mjeteve higjiëno-sanitare për të gjithë personat me aftësi të kufizuara të cilëve iu duhen ato sipas vlerësimit nga KVAK.
- Në lidhje me funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare, KLSH¹⁷ ka adresuar si mangësi faktin se MSHMS dhe institucionet e varësisë nuk kanë informacion se sa mjek janë të angazhuar në procesin e vlerësimit të komisioneve të ngritur nga institucionet arsimore, që tregon mungesë serioziteti dhe neglizhencë në kryerjen e një procesi shumë të rëndësishëm siç është vlerësimi i nevojave arsimore të fëmijëve me AK. Komisionet Multidisiplinare kanë për detyrë të rekomandojnë për nxënësit me AK shërbime mbështetëse jashtë shkollës (terapi zhvillimi, terapi sjellje, logopedi,), por numri dhe kapacitetit i institucioneve ku fëmijët mund të marrin këto shërbime janë shumë të pakta.

¹⁷ KLSH _ Raport Auditimi Performance “Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara”, Dhjetor 22
17

3.5 Politika 6 - Shërbimet Shëndetësore:

➤ Masa të konfirmuara nga institucionet si të realizuara:

- Në nivel kombëtar janë krijuar dhe funksionojnë **10 qendra komunitare të shëndetit mendor** dhe **14 shtëpi të mbështetura** të cilat ofrojnë shërbime multidisiplinare për personat me probleme të shëndetit mendor.
- Eshtë rinovuar Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese e Fëmijëve, duke përmirësuar dhe zgjeruar shërbimet terapeutike dhe rehabilituese që ofron kjo qendër për fëmijët e grupmoshave nga 0-6 vjeç në **0-18 vjeç**, duke përfshirë fëmijët dhe adoleshentët, nga një ekip i dedikuar i përbërë nga **33 terapistë rehabilitues dhe edukativ**.
- Personat me AK përfitojnë nga paketat e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimet spitalore që mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.
- Shpenzimet e shtrimit në spital, ndërhyrjes dhe implantit koklear mbulohen nga buxheti i shtetit dhe financohen 100% nga Fondi i Sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.
- Shërbimi dentar falas për personat me AK ofrohet në Klinikën Stomatologjike Spitalore Universitare, shërbim i cili lidhet me nevojat specifike të personave me AK:
- Njëkohësisht është miratuar një program i dentistrisë dhe programi i kontrollit të syve për cdo fëmijë të regjistruar në shkolla, përfshirë personat me AK.

➤ Mangësi të evidentuara:

- Hartimi i një udhëzimi të vecantë për lehtësimin e vizitave mjekësore në institucionet shëndetësore parësore për personat me AK.
- Hartimi i standarteve lidhur me shërbimet shëndetësore që u jepen banorëve të shtëpive sociale dhe të mbështetura për personat me aftësi të kufizuara intelektuale.

3.6 Politikat 7 & 8 – Gjithëpërfshirja dhe bashkëpunimi midis institucioneve:

➤ Masa të konfirmuara nga institucionet si të realizuara:

- MSHMS është fokusuar në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ndikimin në grupet vulnerabël, duke qene se barazia e mundësive dhe mosdiskriminimi janë pjesë e OZHQ-ve në Axhendën 2030.
- Projekti i PNUD LNB “Askush të mos mbetet pas” ka mbështetur hartimin e planeve sociale në bashki. Në këto plane trajtohen disa çështje të rëndësishme për aftësinë e kufizuar, por jo aksesueshmëria. LNB do të vazhdojë të fokusohet tek personat dhe grupet e cenueshme për të pasur akses të përmirësuar në shërbimet publike që mbështesin përfshirjen dhe mirëqenien e tyre sociale. Është ofruar mbështetje përmes LNB për organizimin e personave me aftësi të



kufizuara në forumet e advokimit për akses në shërbime publike cilësore dhe informacion për personat që nuk dëgjojnë mbi të drejtat e tyre.

➤ **Mangësi të evidentuara:**

- Mungesa e nje Guide Metodologjike në ndihmë të Bashkive në kryerjen e një vlerësimi të nevojave të përfshirjes së personave me AK që jetojnë në territorin e tyre
- Mangësi e evidentuar me statistikat per gjithëpërfshirjen e personave me AK në 8 politikat.

4. Analiza financiare e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për PAK dhe harmonizimi me Programet e Buxhetimit (Buxhetimi Vjetor dhe Programi Buxhetimit Afatmesem 23-35)

Plani Kombëtar i Veprimit për PAK për periudhën 5-vjeçare 2021-2025 ka patur një reduktim të kostove, krahasuar me planin e mëparshëm 2016-2020, pavarësisht se norma e zbatimit të masave nga plani i kaluar ka qenë e ulët dhe aktivitetet janë mbartur për zbatim në planin e ri¹⁸. Buxheti total i parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të PKVPAK 21-25 është rreth **1.47 miliard lekë**, me një rënie prej 26% krahasuar me buxhetin e PKVPAK 16-20 (2 miliard lekë). Rënia më e madhe është planifikuar në sektorët: **arsimi -56%, kujdesi shëndetësor -52% dhe kujdesi social -34%**.

Programi i buxhetimit afatmesëm 2021-2023, bashkë me fondet e angazhuara nga donatorët e identifikuar deri në momentin e miratimit të PKVPAK 21-25, mbulojnë rreth **38% të kostos totale** të planit. Pjesa tjetër, rreth 44% e kostove planifikohet të perfshihen në programin e buxhetimit afatmesëm 24-25, ndërsa **hendeku financiar mbetet i lartë, mbi 18% e kostove totale** të planit për periudhën 2021-2025.

Raport progresi vjetor i monitorimit nga ana e institucioneve duhet të bëjë transparente edhe pjesën financiare të zbatimit të planit kombëtar të veprimit, bashkë me përpjekjet e bëra për rishikimin e buxhetit apo identifikimin e donatorëve për të mundësuar zbatimin në kohë të aktiviteteve dhe përdorimin në mënyrë efektive të fondeve publike dhe ato të donatorëve apo shoqërisë civile. **Ky raportim mungon, qoftë në shqyrtimin e programeve buxhetore afatmesme të detajuara sipas institucioneve dhe objektivave, ashtu edhe në raportimet e monitorimit të buxhetit nga vetë institucionet përgjegjëse.**

➤ Vlerësim i përgjithshëm mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025

Pavarësisht se arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale mbeten prioritetet e qeverisë, nga buxheti afatmesem vërejmë se pesha që zënë shpenzimet e institucioneve respektive kundrejt totalit të shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë do të jenë në rënie për periudhën 2023-2025:

- ✓ Buxheti i MSHMS – nga 11.8% në vitin 2022 do të reduktohet në 11% në vitin 2025;
- ✓ Buxheti i MAS – nga 7.2% në vitin 2022 do të reduktohet në 6.9% në vitin 2025.

E njëjta tendencë vërehet edhe për peshën që do të zënë shpenzimet e MSHMS dhe MAS ndaj produktit të brendshëm bruto PBB, një tregues i krahasueshëm ndër vite dhe midis vendeve:

- ✓ Buxheti i MSHMS – nga 4.11% në vitin 2022 do të reduktohet në 3.5% në vitin 2025;

¹⁸ RAPORT I DYTË I MONITORIMIT TË PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (2016-2020) "Të dhënat e këtij raporti të dytë monitorimi tregojnë se në perceptimin e personave me aftësi të kufizuara, familjarëve të tyre dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë, të gjithë qëllimet specifike ende vlerësohen në nivel aspak ose pak të kënaqshëm".

https://adrf.al/images/publications/raporti_i_monitorimit_permbledhje.pdf

- ✓ Buxheti i MAS – nga 2.43% në vitin 2022 do të reduktohet në 2.29% në vitin 2025.

Reduktimi relativ i shpenzimeve për institucionet MSHMS dhe MAS do të reflektohet në një përkeqësim relativ të shërbimeve të ofruara për mbrojtjen sociale dhe arsimin gjithëpërfshirës të grupeve në nevojë, përfshirë zbatimin e planit të veprimit për PAK.

Tabela 4. Programi i Buxhetimit Afatmesëm 2023 - 2025

Shpenzimet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2023-2025				
	Shpenzimet totale			
	AN nr.3/2022	PBA 2023	PBA 2025	PBA 2025
Në % ndaj PBB	4.11%	3.87%	3.66%	3.50%
Në % ndaj Shpenzimeve të Përgjithshme të Qeverisë	11.8%	12.1%	11.5%	11.0%
Në vlerë nominale (mln leke)	76,722	76,118	75,874	76,481

Shpenzimet për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në vlerë nominale (në mln lekë) dhe në % ndaj PBB 2023-2025				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2022	PBA 2023	PBA 2024	PBA 2025
Në vlerë nominale (mln lekë)	45,458.3	44,484.0	46,736.6	48,106.6
Në % ndaj PBB	2.43%	2.26%	2.26%	2.20%
Në % ndaj Shpenzimeve të Përgjithshme të Qeverisë	7.02%	7.09%	7.07%	6.90%

➤ **Programi 10430 Perkujdese Social (MSHMS):**

Shqipëria shpenzon rreth 9.5 përqind të produktit të brendshëm bruto (PBB) për mbrojtjen sociale, sa gjysma e normës mesatare prej 18.6 përqind e PBB-së referuar 27 vendeve të Bashkimit Evropian¹⁹. Për vitin 2022, totali i shpenzimeve të planifikuara për funksionin e mbrojtjes sociale është 181 miliardë lekë, ku peshën kryesore e zënë pensionet dhe papunësia, ndërsa perkujdesja sociale zë rreth 15% të fondit (rreth 27 miliardë lekë). Perkujdesja sociale përfshin pagesat dhe shërbimet për aftësi të kufizuar (PAK dhe invalid pune) si dhe mbështetjen e individëve dhe familjeve në nevojë (ndihma ekonomike - NE). Nga totali i shpenzimeve për perkujdesje sociale, 98 përqind e buxhetit mbulon pagesat cash (PAK, NE, bonusi i bebeve) dhe vetëm 2 përqind shërbimet sociale. Fondi i planifikuar për aftësinë e kufizuar (PAK, kujdestarë dhe invalid), për vitin 2022 është rreth **18 miliardë lekë, me një peshë 10% të totalit të shpenzimeve të mbrojtjes sociale.**

¹⁹ STRATEGJIA KOMBËTARE E MBROJTJES SOCIALE 2015-2023, RAPORT PROGRES VITI 2020
<https://shendetesia.gov.al/perkujdesi-social/>

Tabela 5. Buxheti i periudhës 2021-2022 për programin 10430 Përkujdesja Sociale

Titulli	Emri i Programit (milion lekë)	Buxheti 12M-viti 2021	Buxheti 12M-viti 2022	Ndryshimi %
	Funksioni - Mbrojtja Sociale	173,667	181,102	+4.28%
	Buxheti MSHMS	70,453	74,714	+6.05%
10430	Programi Përkujdesi Social	27,979	26,753	-4.38%
91307AA	Familje/Individë qe përfitojne - skema NE	6,700	6,816	+1.7%
91307AB	PAK, kujdestarë dhe Invalid pune që përfitojnë pagesa AK	17,280	17,530	+1.5%
91307AG	Grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet	120	120	0%
91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësisve vendore nga financimi i fondit social	200	200	0%
91307AM	PAK që përfitojnë shërbime të përkujdesit social		198	
91370AD	Bonusi i bebeve	2,600	2,200	-15.4%
	Prodhimi i Brendshëm Bruto PBB	1,644,077	1,889,839	+14.9%
	Shpenzime per Perkujdesin Social ne perqindje ndaj PBB-se	1.7%	1.4%	
	Shpenzimet Publike gjithsej	596,279	660,693	+10.8%
	Shpenzime per Perkujdesin Social ne % ndaj Shpenzimeve Publike	4.7%	4.1%	

Burimi: MFE – Buxheti

Shpenzimet faktike monitorohen dhe raportohen nga MSHMS për periudha 4 mujore, por nuk ka një raportim të shpenzimeve faktike sipas programeve dhe aktiviteteve për të gjithin vitin financiar. Referuar raportit të MSHMS për monitorimin e buxhetit për 8-mujorin e vitit 2022, realizimi i shpenzimeve për programin Përkujdesja Sociale është rreth 17.9 miliardë lekë (64% e planit), nga 27.9 miliardë lekë të planifikuara për vitin 2022. Brenda këtij shpenzimi, fondet për PAK për vitin 2022 janë planifikuar rreth 17.5 miliardë lekë, ndërkohë që realizimi për 8-mujorin e vitit 2022 është në masën 11.9 miliardë lekë (66% e planit). Nga ky fond kanë përfituar gjithsej mesatarisht **70,405 persona me AK, 18,177 kujdestarë** dhe 72,865 persona si invalid pune, **me një përfitim mesatar mujor rreth 8,965 lekë për person:**

- ✓ për vitin 2021 – përfitimi total rreth 101.1 mijë lek/person;
- ✓ për vitin 2020 – përfitimi total rreth 110.9 mijë lek/person.

Nga analiza e buxhetit vërehet se mungon një harmonizim midis treguesve të performancës së programit të buxhetimit afatmesëm 2023-2025 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për PAK 2021-2025. Në dokumentin e miratuar të PKV-PAK 21-25, tabela e planifikimit financiar parashikon disa masa që planifikohen të realizohen në vitin 2022 dhe që përfshihen në **programin 10430 Përkujdesja Sociale**. Në monitorimin e buxhetit për periudhën 8-mujore si dhe në relacionin e planifikimit të buxhetit për vitin 2023 nuk prezantohen si aktivitete për tu zbatuar, psh: Trajnimi i personelit të shërbimeve sociale për të aplikuar në mënyrën e duhur shërbimin për lloje të ndryshme të AK, përfshirë ofrimin e shërbimeve bazë në gjuhën e shenjave (realizimi 2022 me hendek financiar); Kryerja e një vlerësimi lidhur me aplikimin e vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social në rajonin e Tiranës dhe impaktin e tij në jetesën e personave me AK dhe prezantimi i rezultateteve në KKAK (realizimi 2022 me hendek financiar); apo Zhvillimi i një plani mbështetjeje për përkujdesin social për personat me aftësi të kufizuara pasi largohen nga institucionet rezidenciale të përkujdesit social, në bashkëpunim me Bashkitë (realizimi 2022).

Në fushën e përkujdesit social, qeveria planifikon të financojë politikat e rishikimit të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, me një rritje prej 10 për qind të masës së pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes. Ndërsa pagesa për përfitues PAK nga programi buxhetor rezulton të rritet vetëm me 5% në tre vitet e ardhshme 2023-2025, referuar programit të buxhetimit afatmesëm.

